

TEORIA SI PRAKTIKË ÇLIRIMTARE

nga bell hooks

Përktheu në shqip: Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist

(Ky artikull është përshtatur nga fjalimi i saj kryesor në Feminizmi i viteve të 90-a: Konferenca: Tejkalimi i hendekut midis teorisë dhe praktikës.)

Më lejoni të filloj duke thënë se unë i hyra teorisë sepse isha e lënduar - dhimbja brenda meje ishte aq e fortë sa nuk mund të vazhdoja jetën. Erdha në teori e dëshpëruar, duke dashur të kuptoja atë që po ndodhte përreth dhe brenda meje. Më e rëndësishmja, doja që dhimbja të largohej. Kështu, e pashë teorinë si një vend për shërim. Erdha në teori, si e re kur isha ende fëmijë. Në librin *Rëndësia e teorisë*, Terry Eagleton thotë:

Fëmijët janë teoricienët më të mirë, pasi që ata/o ende nuk janë edukuar të pranojnë rutinën e praktikave tona shoqërore si "të natyrshme" dhe kështu ata/o insistojnë të pyesin për ato praktika që janë turpërisht më të përgjithshmet e baziket, duke iu referuar atyre me një distancim kureshtar, diçka që ne të rriturit/at e kemi harruar prej kohësh. Meqenëse ata/o ende nuk i kapërdijnë praktikat tona shoqërore si të pashmangshme, ato/a nuk e kuptojnë pse ne nuk mund t'i bëjmë gjërat ndryshe.¹

Në fëmijëri, kurdo që jam përpjekur t'i shtyejë tjerët/at përreth meje t'i bëjnë gjëra ndryshe, për ta parë botën ndryshe, duke përdorur teorinë si ndërhyrje, si një mënyrë për të sfiduar status quo-në, jam ndëshkuar. Mbaj mend që qysh në moshë të re u përpoqa t'i shpjegoja nënës arsytet pse mendoja se ishte shumë e papërshtatshme që babai, ky burrë që mezi fliste me mua, të kishte të drejtën e disiplinimit tim, të më rrahte me kamxhik; përgjigja e saj sugjeronte se isha e çmendur dhe se kisha nevojë për ndëshkim më të shpeshtë.

Merreni me mend, këtë çift të ri zezak që lufton para së gjithash për të praktikuar normën patriarkale (që gruaja të qëndrojë në shtëpi, të kujdeset për fëmijët dhe shtëpinë derisa burri punon) edhe pse si i tillë ky organizim nënkuptonte që ekonomikisht ata do të jetonin gjithmonë me më pak. Mundohuni të imagjinoni se si duhet të ketë qenë për ta, secili/a prej tyre duke punuar fortë çdo ditë, duke luftuar për të mbajtur një familje me shtatë fëmijë si dhe duke i bërë ballë një fëmije mendjendritur që pyet vazhdimisht e që guxon të sfidojë autoritetin mashkullor dhe që rebelohet kundër vetë normës patriarkale që ky çift përpiqej fuqishëm ta institucionalizojë.

¹ Terry Eagleton, *Rëndësia e teorisë*, faqe 34 (1990).

A tyre duhet t'u jetë dukur se një përbindësh ishte shfaqur në mesin e tyre në formën dhe trupin e një fëmije - një figurë e vogël e djallëzuar që kërcënonte të përmbyste dhe minonte gjithçka që ata donin të ndërtonin. Nuk është çudi që përgjigja e tyre ishte shtypja, frenimi, ndëshkimi. Nuk është çudi që nëna do të më thoshte herë pas here, e zemëruar, e frustruar: "Nuk e di ku të kam marrë por me siguri do të doja të të ktheja prapa".

Imagjinojeni, nëse mundeni, dhimbjen time të fëmijërisë. Nuk ndihesha njëmend e lidhur me këta njerëz të çuditshëm, me këta njerëz të familjes që jo vetëm që dështuan së kuptuari pikëpamjen time të botës por edhe thjesht nuk donin as ta dëgjonin. Si fëmijë, nuk e dija prej nga kisha ardhur. Dhe kur nuk po kërkoja dëshpërimisht t'i përkisja këtij komuniteti familjar që dukej se asnjëherë nuk do të më pranonte apo të më dëshironte, po përpiqesha dëshpërimisht të zbuloja vendin ku përkasë. Përpiqesha dëshpërimisht të gjej rrugën time për në shtëpi. Sa e kisha zili *Dorothy-n* në udhëtimin e saj në "*Magjistari i Ozit*", për atë që ajo të mund të udhëtonte drejt frikës dhe ankthit të saj më të tmerrshëm vetëm për të gjetur në fund se "nuk ka vend si shtëpia". Duke jetuar në fëmijëri pa ndjenjën e shtëpisë, gjeta një vend të shenjtë në "teorizim", në të kuptuarit e asaj që po ndodhte. Gjeta një vend ku munda imagjinoja të ardhmen e mundshme, një vend ku jeta mund të jetohet ndryshe. Kjo përvojë e "jetuar" e mendimit kritik, e reflektimit dhe e analizës, u bë vendi ku kam punuar për të shpjeguar dhimbjen dhe për ta larguar atë. Në thelb, nga kjo përvojë mësova se teoria mund të ishte një vend i shërimit.

Psikoanalistja Alice Miller, në hyrje të librit të saj *Të burgosurit e fëmijërisë*², na bën të ditur se ishte lufta e saj personale për t'u rikuperuar nga plagët e fëmijërisë ajo që e shtyu atë të rimendonte dhe të teorizonte përsëri një mendim mbizotërues shoqëror dhe kritik për kuptimin e dhimbjes së fëmijërisë dhe atë të abuzimit të fëmijëve. Në jetën e saj si e rritur, përmes praktikës së saj, ajo e përjetoi teorinë si një vend shërimi. Në mënyrë domethënëse, asaj iu desh ta imagjinonte vetën në hapësirën e fëmijërisë, të shikonte përsëri nga ai këndvështrim, të kujtonte "informacionet thelbësore, përgjigjet e munguara të pyetjeve të mëparshme gjatë gjithë studimit [të saj] të filozofisë dhe psikoanalizës."³ Kur përvoja jonë e jetuar dhe teorizimi janë të ndërlidhura thelbësisht me proceset e vetë-shërimit, të çlirimit kolektiv, atëherë nuk ekziston më asnjë hendek midis teorisë dhe praktikës. Në të vërtetë, ajo që e bënë një përvojë e tillë më të qartë është ndërlidhja midis dy - këtyre proceseve reciproke që në fund të fundit njëri mundëson tjetrin.

Teoria në vetvete nuk është shëruese, çliruese ose revolucionare. Ajo e përmbushë këtë funksion vetëm atëherë kur ne kërkojmë që ajo ta bëjë këtë dhe e drejtojmë teorizimin tonë drejt këtij qëllimi. Kur isha fëmijë, sigurisht që proceset e mendimit dhe kritikës me

² Alice Miller, *Drama e fëmijës së të talentuar: Kërkimi për vetën e vërtetë XI-XV* (1990) (botuar më parë si "*Të burgosurit e fëmijërisë*") (1981)

³ Id, në XIV

të cilat merresha nuk i përshkruaja si "teorizime". Megjithatë, siç kam sugjeruar në librin *Teoria feministe: Nga margjina në qendër*,⁴ zotërimi i një termi nuk sjellë në jetë një proces apo praktikë; Në të njëjtën kohë, dikush mund të teorizojë pa e ditur/zotëruar termin, ashtu siç mund të jetojmë dhe të veprojmë në rezistencën feministe pa përdorur asnjëherë fjalën "feminizëm".⁵

Shpesh individët që përdorin lirshëm termat e caktuar si "teori" ose "feminizëm" nuk janë domosdoshmërisht praktikues - shprehitë e të jetuarit të së cilëve duhet të mishërohen me veprimin- praktikën e teorizimit ose përfshirjen në rezistencën feministe. Në të vërtetë, akti i privilegjuar i emërtimit shpesh u mundëson atyre që janë në pushtet të kenë qasje në mënyrat e komunikimit, gjë që iu mundëson të projektojnë interpretime, përkufizime, përshkrime të punës së tyre, veprimeve, etj; e që mund edhe të mos jenë të sakta ose të fshehin atë që në të vërtetë është duke u zhvilluar. Eseja e Katie King "Prodhimi i seksit, teorisë dhe kulturës: Rihartësimi i termeve gej/heteroseksual në feminizmin bashkëkohor" është një diskutim shumë i dobishëm për mënyrën se si prodhimi akademik i teorisë feministe i formuluar në ambiente hierarkike shpesh iu mundëson grave, veçanërisht grave të bardha, me status dhe dukshmëri më të lartë artikulohe mbi punën e studiuesve feministe që mund të kenë status më të ulët ose të mos kenë fare, më pak ose aspak dukshmëri, pa i njohur ato si burime. Duke diskutuar për mënyrën se si përvetësohet puna dhe/ose mënyra se si lexueset/it shpesh ia atribuojnë idetë një studiueseje mendimtareje të njohur feministe, edhe nëse ajo/ ka cituar në punën e saj duke argumentuar mbi idetë e mbledhura nga burime më pak të njohura, duke u fokusuar veçanërisht në punën e teoricienes *Chicana* (meksikane-amerikane), Chela Sandoval, King thotë: "Sandoval është botuar vetëm në mënyrë sporadike dhe ekscentrike, megjithatë dorëshkrimet e saj të pabotuara që qarkullojnë janë shumë të cituara dhe shpesh janë përvetësuar, edhe pse diapazoni i ndikimit të saj rrallëherë është kuptuar."⁶ Edhe pse këtu King rrezikon duke e pozicionuar veten në një rol kujdestar, përderisa retorikisht merr qëndrimin e autoritetit feminist duke përcaktuar gamën dhe shtrirjen e ndikimit të Sandoval, qëndrimi kritik që ajo tenton të theksojë është se prodhimi i teorisë feministe është kompleks dhe se është më pak praktikë individuale nga çka ne shpesh mendojmë dhe se zakonisht prodhohet nga ndërveprimi ynë me me burimet kolektive. Duke i bërë jehonë teoricienëve feministe, veçanërisht grave me ngjyrë që kanë punuar vazhdimisht për t'i rezistuar ndërtimit të kufijve kufizues kritikë brenda mendimit feminist, King na inkurajon të kemi një perspektivë më të gjerë mbi procesin e teorizimit.

Reflektimi kritik mbi prodhimin bashkëkohor të teorisë feministe e bën të qartë se rrëshqitja nga konceptualizimet e mëhershme të teorisë feministe, të cilat këmbëngulnin se më qenësorja ka qenë që ato të inkurajojnë dhe mundësojnë praktikën feministe, fillon të bëhet më e dukshme me segregimin dhe institucionalizimin e procesit të

⁴ bell hooks: *Nga margjina në qendër* (1984)

⁵ Shih id në faqet 17-31.

⁶ Id në faqe 90

teorizimit feminist në akademi, me privilegjimin e mendimit/teorisë së shkruar feministe kundrejt rrëfimeve gojore.

Në të njëjtën kohë, përpjekjet e grave zezake/grave me ngjyrë për të sfiduar dhe dekonstruktuar kategorinë "grua", këmbëngulja e tyre për ta njohur atë se gjinia nuk është faktori i vetëm që përcakton sajësat femërores, paraqet një ndërhyrje kritike që ka çuar në një revolucion të thellë në mendimin feminist, një ndërhyrje që vërtet ka vënë në pyetje dhe ka prishur teorinë hegjemoniste feministe, të prodhuar kryesisht nga gra akademike, shumica e të cilave ishin gra të bardha.

Në vazhden e kësaj thyerje, ky sulm kritik ndaj supremacisë së bardhë, që ndodhi në praktikat kritike feministe çoi në krijimin e aleancave midis akademikeve (gra të bardha) dhe akademikëve (burra të bardhë) me qëllim që të zhvillojë përpjekje të përbashkëta për të formuluar dhe imponuar standarde të vlerësimit kritik që do të përdreshin për të përcaktuar se çfarë është apo nuk është teorike. Këto standarde shpesh çuan në përvetësim dhe/ose zhvlerësim të punës që nuk ishte "e përshtatshme" e që papritmas u konsiderua jo teorike ose jo mjaftueshëm teorike. Në disa qarqe, duket se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis studiueseve feministe të bardha që anojnë drejt punës dhe teorisë kritike të prodhuar nga burrat e bardhë, si dhe distancimit të studiueseve feministe të bardha nga respektimi dhe vlerësimi i plotë i njohurive kritike dhe kontributet teorike të grave zezake/grave me ngjyrë.

Puna e grave me ngjyrë dhe grupeve të margjinalizuara të grave të bardha (për shembull, lezbiket, *radikalet e seksit*), veçanërisht nëse shkruhet në një mënyrë që e bën atë të qashme për një publik të gjërë lexuesesh/ish, edhe nëse kjo punë mundëson dhe promovon praktikën feministe, shpeshherë është e delegjitimuar në mjediset akademike. Megjithatë një punë e tillë shpesh përvetësohet nga vetë individët që vendosin standarde kufizuese kritike, pikërisht ajo punë që ato/a më shpesh pretendojnë se nuk është në të vërtetë teori ose nuk është mjaftueshëm teorike. Është e qartë se një nga manovrimet që bëjnë këto/a individë/ë mbi teorinë është instrumentalizimi i saj. Ato/a e përdorin atë për të ngritur hierarki të panevojshme dhe konkurruese të mendimit, të cilat rishkruajnë politikën e dominimit duke përcaktuar një punë inferiore, superiore, si më shumë ose më pak të denjë për vëmendje. Në esenë e saj, King thekson se "teoria gjen përdorime të ndryshme në vende të ndryshme".⁷ Është e qartë se një nga shumë përdorimet e teorisë në hapësirat akademike është në prodhimin e një hierarchie klasore intelektuale ku të vetmet vepra që konsiderohen vërtetë teorike janë ato vepra që janë shumë abstrakte, zhargonistike, të vështira për t'u lexuar dhe që përmbajnë referenca të mangëta që mund të mos jenë aspak të qarta ose të shpjeguara. Kritikja letrare, Mary Childers deklaroi se është shumë ironike që "një lloj i caktuar i performancës teorike që vetëm një kuadër i vogël njerëzish mund ta

⁷ Id në faqe 89;

kuptojnë"⁸ është bërë përfaqësuese e çdo prodhimi të mendimit kritik e cila njihet brenda shumë qarqeve akademike si "teori." Është veçanërisht ironike kur ky bëhet edhe rasti me teorinë feministe. Dhe është e lehtë të imagjinohen vende të ndryshme, hapësira jashtë ndërveprimit akademik ku një teori e tillë jo vetëm që do të shihej si e padobishme por do të shihej edhe si politikisht joprogresive, si një lloj praktike narcisiste-vetëkënaqësie që më së shumti kërkon të krijojë një hendek midis teorisë dhe praktikës në mënyrë që të përjetësojë elitizmin klasor. Ka qaq shumë mjedise në këtë vend ku fjala e shkruar ka vetëm një kuptim të vogël vizual, ku individët që nuk dinë të lexojnë apo shkruajnë nuk mund të gjejnë asnjë përdorim për një teori të botuar sado të kthjellët apo të errët. Prandaj, çdo teori që nuk mund të ndahet në bisedat e përditshme nuk mund të përdoret për të edukuar publikun.

Imagjini se çfarë ndryshimi mund të ndodhë brenda lëvizjeve feministe kur studentet/ët, shumica e të cila/ëve janë gra, vijnë në klasët e studimeve të grave dhe lexojnë atë që u thuhet që është teori feministe për të kuptuar që ajo po lexojnë nuk ka fare kuptim, nuk mund të mirëkuptohet ose kur kuptohet nuk lidhet në asnjë mënyrë për realitete të "jetuara" përtej kësaj klase. Si aktiviste feministe, ne mund të pyesim vetën se çfarë përdorimi ka teoria feministe që sulmon psikikën e brishtë të grave që luftojnë për të hedhur poshtë grackën shtypëse të patriarkatit. Mund të pyesim vetën, çfarë dobie ka teoria feministe që tekstualisht i godet ato, duke i hedhur hi syve në mjediset e klasës së studimeve dhe duke i poshtëruar, duke i bërë të ndjehen sikur të mund të qëndronin lehtësisht në një dhomë ndenjeje ose dhomë gjumi diku lakuriq me dikë që i ka joshur ose do t'i joshte ato, që pastaj i nënshton ndaj një procesi ndërveprimi që i poshtëron dhe që i zhvesh nga ndjenja e vlerës. Është e qartë se një teori feministe që mund ta bëjë këtë mund të funksionojë për të legjitimuar studimet e grave dhe shkollimin feminist në sytë e frontit patriarkal, përderisa minon dhe përmbys lëvizjet feministe. Ndoshta, është ekzistenca e kësaj teorie feministe shumë të dukshme që na detyron të flasim për hendekun midis teorisë dhe praktikës. Sepse me të vërtetë qëllimi i një teorie të tillë është që të na ndajë, përçajë, përjashtojë e distancojë. Dhe për shkak se kjo teori vazhdon të përdoret për të na heshtur, censuruar dhe zhvlerësuar zërat e shumtë teorikë e feministë, ne nuk mund ta injorojmë atë. Njëkohësisht, pavarësisht nga përdorimi i kësaj teorie si një instrument dominimi, ai mund të përmbajë gjithashtu ide, mendime të rëndësishme, vizione, të cilat, nëse përdoren ndryshe, mund të shërbejnë për një funksion shërues, çlirues. Megjithatë, ne nuk mund të injorojmë rreziqet që paraqet për rezistencën feministe e cila duhet të jetë i rrënjësuar në një teori që informon, formëson dhe e bën praktikën feministe të mundshme.

Brenda qarqeve feministe, shumë gra i janë përgjigjur teorisë feministe hegjemoniste që nuk na flet qartë, me këtë teori hegjemoniste të plehrave e cila si pasojë promovon më tej dikotominë e rreme midis teorisë dhe praktikës. Prandaj, ato bashkëpunojnë me ata që rëndom do t'i kundërshtonin. Duke përbrendësuar supozimin e rremë se teoria nuk është një praktikë shoqërore, ato promovojnë brenda qarqeve feministe

⁸ Mary Childers & bell hooks, Një bisedë rreth racës dhe klasës, në "Konfliktet në feminizëm", shënimi i mësipërm 6, në faqe 60, 77.

formacionin e një hierarkie potencialisht shtypëse, ku të gjitha veprimet konkrete shihen si më të rëndësishme se çdo teori e shkruar ose e folur. Kohët e fundit, shkova në një mbledhje grash, kryesisht zezake, ku diskutuam nëse liderët zezak burra, si Martin Luther King dhe Malcolm X, duhet t'i nënshtrohen kritikave feministe që shtrojnë pyetje të vështira për qëndrimin e tyre ndaj çështjeve gjinore. I gjithë diskutimi zgjati në më pak se dy orë. Në mbylljen e diskutimit, një grua zezake, e cila kishte qenë kryesisht e heshtur, foli për të thënë se nuk ishte e interesuar për gjithë këtë teori dhe retorikë, gjithë këtë bisedë, se ishte më e interesuar për veprim, për të bërë diçka, dhe se ajo thjesht ishte "lodhur" nga të gjitha bisedat.

Përgjigja e saj më shqetësoi: ishte një reagim tashmë i njohur. Ndoshta ajo jeton në jetën e saj të përditshme në një botë të ndryshme nga e imja. Në botën në të cilën jetoj çdo ditë, rastet kur gratë mendimtare zezake/me ngjyrë mbledhen së bashku për të debatuar në mënyrë rigorozë çështje të racës, gjinisë, klasës dhe seksualitetit janë të rralla. Prandaj, nuk e dija se nga vinte ajo kur sugjeroi që biseda, pra diskutimi që po bënim, ishte i rëndomtë, aq sa mund edhe të bënim pa të. Ndjeva se ishim duke u përfshirë në një proces dialogu dhe teorizimi kritik që prej kohësh ka qenë temë tabu. Prandaj, nga këndvështrimi im, ne po hartonim udhëtime të reja, duke marrë një terren intelektual për veten tonë si gra zezake ku mund të fillonim ndërtimin kolektiv të teorisë feministe.

Në shumë ambiente me njerëz me ngjyrë të zezë, kam qenë dëshmitare e neglizhimit të intelektualëve/eve, zhvleftësimit e e teorisë dhe kam heshtur. E tash e kam kuptuar që ajo heshtje ka qenë akt që më ka bërë bashkëfajtorë, një akt i cili i ndihmon përjetësimin të idesë se ne mund të përfshihemi në çlirim revolucionar të zezakëve dhe/ose rezistencë feministe pa teori. Ashtu si shumë intelektuale/ë zezake/ë kryengritëse/ës, puna intelektuale dhe mësimdhënia e të cila/ëve shpesh bëhet në mjedise kryesisht të bardha, edhe unë shpesh jam aq e kënaqur që jam angazhuar në një grup kolektiv njerëzish me ngjyrë të zezë, sa që nuk dua të shkaktoj probleme ose ta distancoj vetën duke mos u pajtuar me grupin. Në të kaluarën, në mjedise të tilla ku puna e intelektualëve/eve është zhvlerësuar, rrallëherë kam kundërshtuar supozimet mbizotëruese ose të kem folur në mënyrë afirmative ose pasionante për procesin intelektual. Kjo nga frika se nëse do të mbaja një qëndrim që do të këmbëngulte në rëndësinë e punës intelektuale, veçanërisht të teorizimit ose nëse thjeshtë do të deklaroja se mendoja se ishte e rëndësishme të lexojmë më tepër, do të rrezikoja të shihesha si e pakëndshme ose si superiore. Kështu që shpesh kam heshtur.

Të rrezikosh vetveten ndaj këtyre goditjeve sot duket e rëndomtë kur merret parasysh kriza me të cilën po përballemi si afrikano-amerikanë, me nevojën tonë të dëshpëruar për të rindezur dhe mbështetur flakën e luftës çlirimtare të zezakëve. Në tubimin që e përmenda më lartë, morra guximin të flas, duke iu kundërpërgjigjur sugjerimit të asaj që ne po humbnim kohën duke folur, duke thënë se fjalët tona i shihja si veprim dhe se lufta jonë kolektive për të diskutuar çështjet gjinore dhe të racës pa censurë ishte një praktikë agjitative. Kjo për të na nxitur të mendojmë se shumë nga çështjet me të cilat ne vazhdojmë të përballemi si zezakë - vetëbesimi ulët, nihilizmi dhe dëshpërimi i

intensifikuar, zemërimi dhe dhuna e shtypur që shkatërron mirëqenien tonë fizike dhe psikologjike - nuk mund të adresohen më prej strategjive të mbijetesës që mund të kenë funksionuar në të kaluarën. Vazhdova të këmbëngulja që ne kemi nevojë për teori të reja që mund të na çojnë drejt rezistencës revolucionare, të rrënjosur në një përpjekje e cila rreket për ta kuptuar natyrën e problematikës sonë bashkëkohore si dhe mjetet me të cilat ne mund të përfshihemi kolektivisht në luftën e rezistencës që do të transformonte realitetin tonë aktual. Megjithatë, nuk isha rigorozë dhe e pamëshirshme siç do të kisha qenë në një mjedis tjetër në përpjekjet e mia për të theksuar rëndësinë e punës intelektuale, prodhimin e teorisë si një praktikë shoqërore që mund të jetë çlirimtare. Ndonëse nuk kisha frikë të flisja, nuk doja të shihesha si ajo që "prishja" kohën e mirë dhe ndjenjën e këndshme kolektive të solidaritetit mes komunitetit zezak. Kjo frikë më kujtoi se si ishte më shumë se dhjetë vjet më parë të qenit në mjediset feministe, duke shtruar pyetje rreth teorisë dhe praktikës, veçanërisht rreth çështjeve të racës dhe racizmit që shiheshin si potencialisht përçarëse të motërzimit dhe solidaritetit.

Dukej ironike që në një tubim të thirrur për të nderuar një lider burrë zezak, i cili shpesh kishte guxuar të fliste dhe të vepronte në rezistencë ndaj status quo-së, gratë e zeza ende e mohonin të drejtën tonë për t'u përfshirë në dialog dhe debat politik kundërshtues, veçanërisht për shkak se kjo nuk është një dukuri e zakonshme në komunitetet e zezakëve. Pse në atë kohë gratë e zeza ndjenin nevojën për të policuar njëra-tjetrën, për t'i mohuar njëra-tjetrës një hapësirë brenda komunitetit zezak ku ne mund të flisim pa drojë për teori? Pse, kur mund të festonim së bashku fuqinë e një mendimtari kritik zezak, i cili guxoi të qëndronte veçmas, ekzistonte kjo dëshirë për të shtypur çdo pikëpamje që do të na ftonte të mësonim kolektivisht nga idetë dhe vizionet e intelektualëve/teoricienëve kryengritëse zezake, të cilat nga natyra e punës që bëjnë janë domosdoshmërisht duke e thyer stereotipin që na bënë të besojmë se gruaja zezake "e vërtetë" është gjithmonë ajo që flet nga zorrët, që vazhdimisht lavdëron konkretën mbi abstrakten, apo materialen mbi teorinë?

Prapë se prapë, si gra zezake, ne gjejmë kurajo për të folur, për të thyer heshtjet që do të na mundësonin përfshirjen në debate radikale progresive politike duke kundërshtuar shumë fronte. Ka një ndërlidhje midis tendencës për të na heshtur, censurimit, anti-intelektualizmit në ambiente kryesisht zezake që që supozohet se janë mbështetëse (si hapësirat e grave tërësisht të zeza), dhe ky heshtëzim që po bëhet në institucione ku grave të zeza/me ngjyrë u thuhet se nuk mund të dëgjohen ose të merren parasysh përderisa puna jonë nuk është mjaftueshëm teorike. Kritikja kulturore Kobena Mercer na kujton se "e zeza është ...komplekse dhe e shumëllojshme" dhe se "njerëzit zezak mund të ndryshojnë kursin e tyre drejt një politike reacionare dhe anti-demokratike." Ashtu si disa akademikë/e elitarë/e të cilët/at ndërtojnë teoritë e "të zezës" në atë mënyrë që e bëjnë një terren kritik në të cilin mund të hyjnë vetëm disa të përzgjedhur, duke përdorur punën teorike mbi racën për të mbrojtur autoritetin e tyre për të folur mbi përvojën zezake, duke mohuar kështu qasjen demokratike në procesin e krijimit të teorisë dhe duke kërcënuar rezistencën kolektive çlirimtare të zezakëve. Në anën tjetër kështu bëjnë edhe disa nga komuniteti zezak që reagojnë duke promovuar anti-intelektualizëm dhe duke i shpallur të gjitha teoritë si të pavlera. Kështu, për të

përforsuar idenë se ekziston një ndarje mes teorisë dhe praktikës ose duke krijuar një ndarje të tillë, të dy grupet mohojnë fuqinë e edukimit çlirimtar për vetëdijësim kritik, duke mirëmbajtur kështu rrethanat që mundësojnë shfrytëzimin dhe shtypjen tonë kolektive.

Kohët e fundit m'u kujtua ky anti-intelektualizëm i rrezikshëm kur pranova të shfaqesha në një emision në radio me një grup të burrave dhe grave zezak/e për të diskutuar mbi librin e autores Sherazade Ali "Udhëzuesi i burrit zezak për të kuptuar gruan e zezë".⁹ Aty dëgjova folës/e pas folësi/e duke shprehur përçmim ndaj punës intelektuale dhe kundërshtim ndaj çdo thirrje për prodhimin e teorisë. Një grua zezake ishte mjaft e ashpër në këmbënguljen e saj se "nuk kemi nevojë për asnjë teori". Libri i Ali, anipse i shkruar në gjuhë të thjeshtë, me një stilistikë që përdor gjuhën e përditshme zezake, paraqet një bazë teorike që është i rrënjësor në teoritë e patriarkatit (për shembull, besimi kryesor seksist se dominimi mashkullor ndaj femrave është "i natyreshëm"), se mizogjia është e vetmja përgjigje e mundshme që burrat zezak mund të kenë ndaj çdo përpjekjeje të grave për tu vetëpërbushur plotësisht. Shumë nacionalistë zezakë do të përqafojnë me padurim teorinë dhe mendimin kritik si një armë të nevojshme në luftën kundër supremacisë së bardhë por papritmas do humbasin mbrehtësinë për të kuptuar se teoria është e rëndësishme kur bëhet fjalë për çështjet gjinore, për analizimin e seksizmit dhe shtypjes seksiste mënyrat e veçanta dhe specifike me të cilat manifestohen në përvojën zezake. Diskutimi i librit të shkrimtares Ali është një nga shembujt e shumtë të mundshëm që ilustron mënyrën se si përbuzja dhe shpërfillja e teorisë nënvlerëson luftën kolektive për t'i rezistuar shtypjes dhe shfrytëzimit.

Brenda lëvizjeve revolucionare feministe dhe rezistencës revolucionare për çlirim të zezakëve/eve, ne duhet ta shohim vazhdimisht teorinë si praktikë të nevojshme brenda një kuadri holistik të aktivizmit çlirimtar. Ne duhet të bëjmë më shumë që t'i japim vëmendje mënyrave të keqpërdorimit të teorisë. Ne duhet të bëjmë më shumë se sa të kritikojmë përdorimet konservatore të saj dhe nganjëherë edhe reaktionale që disa gra akademike i bëjnë teorisë feministe. Ne duhet të punojmë në mënyrë aktive për të tërhequr vëmendjen për rëndësinë e të krijuarit të një teorie që mund të çojë përpara lëvizjet e përtrira feministe, veçanërisht duke theksuar teorinë që synon të çojë më tej kundërshtimin feminist ndaj seksizmit dhe shtypjes seksiste. Duke bërë këtë, ne domosdoshmërisht lartësojmë dhe vlerësojmë teorinë që mund të artikulohet në rrëfim gojor dhe në të shkruar.

Duke reflektuar mbi punën time në teorinë feministe, më duket se shkrimi - biseda teorike - më kuptimplote është kur i fton lexueset/it të përfshihen në reflektim kritik dhe të angazhohen në praktikën e feminizmit. Për mua, kjo teori del nga konkretja, nga përpjekjet e mia për t'i dhënë kuptim përvojave të jetës së përditshme, nga përpjekjet e mia për të ndërhyrë në mënyrë kritike në jetën time dhe të tjerëve. Kjo për mua është ajo që e bën të mundur transformimin feminist. Dëshmia personale, përvoja personale, është një terren aq frytdhënës për prodhimin e teorisë feministe çlirimtare sepse

⁹ Sherazade Ali, Udhëzuesi i burrit zezak për të kuptuar gruan zezake (1990)

zakonisht ajo përbën bazën e krijimit të teorisë sonë. Përderisa ne punojmë për t'i zgjidhur ato çështje (nevoja jonë për të mësuar shkrim e lexim, për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, shëndeti i grave dhe të drejtat riprodhuese, nevoja jonë për strehim, për liri seksuale, etj; për t'i përmendur vetëm disa) që janë më urgjente në jetën e përditshme, ne përfshihemi në një proces kritik teorizimi që mundëson të jemi dhe na fuqizon. Unë vazhdoj të jem e habitur që ka kaq shumë shkrime feministe të prodhuara dhe megjithatë kaq pak teori feministe që përpiqet t'u flasë grave, burrave dhe fëmijëve për mënyrat se si mund ta transformojmë jetën tonë nëpërmjet një kthimi drejt politikës feministe rrjedhimisht në praktikën feministe. Ku mund të gjejmë një grup teorish feministe që synon të ndihmojë individët të integrojnë mendimin dhe praktikën feministe në jetën e përditshme? Për shembull, cila teori feministe ka për qëllim të ndihmojë gratë që jetojnë në familje seksiste në përpjekjet e tyre për të sjellë ndryshim feminist?

Ne e dimë se shumë individë në Shtetet e Bashkuara kanë përdorur mendimin feminist për të edukuar veten në mënyra që i lejojnë të transformojnë jetën e tyre. Unë jam shpesh kritike ndaj një feminizmi të bazuar në stilin e jetesës sepse kam frikë se procesi transformues feminist që kërkon të ndryshojë shoqërinë është lehtësisht e instrumentalizueshme nëse nuk i ka rrënjët në një angazhim politik të lëvizjes feministe gjithëpërfshirëse. Brenda patriarkatit kapitalist e supremacist të bardhë, ne kemi qenë tashmë dëshmitare/ë të sendëzimit të të menduarit feminist (ashtu siç e përjetojmë ne sendëzimin e çështjeve zezake), në mënyra që e bëjnë të duket sikur dikush mund të merr pjesë në "të mirën" që prodhojnë këto lëvizje pa ndonjë angazhim ndaj politikës dhe praktikës transformuese. Në këtë kulturë kapitaliste, feminizmi dhe teoria feministe po bëhen shpejt një mall që vetëm të privilegjuarit mund ta bëjnë përballojnë. Po bëhet si një artikull luksi. Ky proces i sendëzimit ndërpritet dhe përmbysset vetëm kur si aktiviste/ë feministe/ë konfirmojmë përkushtimin tonë për një lëvizje feministe revolucionare e politike që ka për agjendë qendrore transformimin e shoqërisë. Nga një pikënisje e tillë, ne mendojmë automatikisht krijimin e teorisë që i flet audiencës më të gjerë të njerëzve. Une kam shkruar dhe jam pronocuar në forume dhe biseda të shumta publike që vendimi im për stilin e të shkruarit dhe për mospërdorimin e formateve konvencionale akademike, është vendim politik i motivuar nga dëshira për të qenë gjithëpërfshirëse, për të arritur sa më shumë lexues/e nga vende të ndryshme të botës. Ky vendim ka pasur pasoja pozitive dhe negative. Studente/ë në institucione të ndryshme akademike shpesh ankohen se nuk mund ta përfshijnë punën time në listat e kërkuara të leximit për provimet kualifikuese të orientuara drejt diplomimit sepse profesoret/ët e tyre nuk më shohin si dijetare. Secila/i prej nesh që krijon teori feministe dhe shkrim feminist në mjedise akademike në të cilat vlerësohemi vazhdimisht, e di se puna e konsideruar si "jo studimore" ose "jo teorike" mund të rezultojë në një punë që mund të mos marrë mirënjohjen dhe shpërblimin e merituar.

Tani, në jetën time këto përgjigje negative duken të parëndësishme krahasuar me përgjigjet jashtëzakonisht pozitive që marr për punën time brenda dhe jashtë akademisë. Kohët e fundit kam marrë një mori letrash nga zezakë të burgosur që kanë leuar punën time dhe kanë dashur të tregonin se janë duke punuar për të ç'mësuar

seksizmin. Në një letër, njëri mburrej që e kishte bërë emrin tim një "emër të njohur brenda atij burgu". Këta burra flasin për reflektimin e izoluar kritik, për përdorimin e kësaj vepre feministe për të kuptuar implikimet e patriarkatit si një forcë që formëson identitetin e tyre, pra idetë e tyre të burrërisë. Pasi mora një përgjigje mbresëlënëse e kritike nga njëri prej këtyre burrave zezak lidhur librin tim të ri "Dëshira të flakta: Raca, gjinia dhe politika kulturore",¹⁰ mbylla sytë dhe vizualizova këtë vepër tek sa lexohej, studiohej e flitej në mjediset e burgut. Pasi që hapësira që më ka kritikuar më shumë për shkrimet e mia ka qenë zakonisht akademike, po e ndaj këtë përvojë jo për t'u mburrur apo për t'u treguar jo modeste por për të dëshmuar, për t'iu njoftuar nga përvoja e dorës së parë që e gjithë teoria jonë feministe ka për qëllim transformimin e vetëdijes dhe se dëshira të bisedojë me audienca të ndryshme funksionon dhe se kjo nuk është një fantazi naive.

Gjatë bisedave të fundit, kam folur se sa "e bekuar" ndihem që puna ime është kaq e njohur dhe që jam një ndër ato teoriciene feministe që krijojnë teori e cila vepron si një katalizator për ndryshimet shoqërore dhe që i kalon kufijtë fiktiv. Në të kaluarën ka pasur shumë raste kur për shkak të punës time jam pushuar nga puna dhe jam ndjerë e zhvlerësuar dhe thellësisht e dëshpëruar. Mendoja se një dëshpërim të tillë mund ta ketë ndjerë çdo grua e zezë/me ngjyrë mendimtare/teoricene, puna e së cilës është opozitare dhe lëviz kundër rrymës. Michele Wallace në hyrjen e saj prekëse të ribotimit të librit "Maço zezak dhe miti i supergruas"¹¹ thotë se për një kohë të gjatë është ndierë e shkatërruar dhe e heshtur nga përgjigjet kritike negative ndaj punës së saj të hershme.

Jam mirënjohëse që mund të qëndroj këtu dhe të dëshmoj se nëse mbahemi fort pas bindjeve tona që të menduarit feminist duhet të ndahet me të gjithë qoftë duke folur, shkruar dhe krijuar teori me këtë agjendë në mendje, ne mund të avancojmë një lëvizje feministe që të gjithë do të dëshirojnë të jenë pjesë e saj. Unë shpërndaj mendim dhe praktikë feministe kudo që jam. Kur më kërkohet të flas në hapësirat e universitetit, unë kërkoj edhe hapësira të tjera ose u përgjigjem atyre që më kërkojnë sepse unë mund t'i jap pasuritë e të menduarit feminist kujtdo. Ndonjëherë hapësirat krijohen spontanisht. Muajin e kaluar isha në jug në një restorant në pronësi të zezakëve dhe u ula për orë të tëra me një grup divers të grave dhe burrave me ngjyrë nga klasa të ndryshme shoqërore duke diskutuar për çështje të racës, gjinisë dhe klasës.

Disa prej nesh ishin të arsimuar në universitet, disa nuk ishin. Kishim një diskutim të zjarrtë mbi abortin, duke diskutuar nëse gratë e zeza duhet të kenë të drejtë për të zgjedhur. Disa nga burrat zezak e afrocentrikë po argumentonin se si burrat duhet të kenë po aq të drejtë zgjedhje sa kanë gratë. Njëra nga gratë zezake feministe e cila ishte drejtore e një klinike shëndetësore për gratë, foli qartë dhe bindshëm për të drejtën e grave për të zgjedhur.

Gjatë këtij diskutimi të zjarrtë, njëra nga gratë, e cila kishte heshtur për një kohë të gjatë dhe që kishte hezitur të hynte në bisedë sepse nuk ishte ndjerë e sigurt nëse mund ta

¹⁰ bell hooks, Dëshira të flakta: Raca, Gjinia dhe Politika Kulturore (1990)

¹¹ Michelle Wallace: Maço zezak dhe miti i supergruas (1979)

artikulonte kompleksitetin e mendimit të saj në të folurën popullore zezake (në mënyrë që ne të dëgjonim e kuptonim dhe të mos talleshim me fjalët e saj), erdhi të me flasë. Ndërsa po largohesha, kjo motër zezake erdhi tek unë dhe më kapi fort të dy duart dhe më falënderoi për diskutimin. Ajo parapriu fjalët e saj mirënjohëse duke treguar se biseda jo vetëm që i kishte mundësuar t'iu jepte zë ndjenjave dhe ideve që i kishte "mbajtur" gjithmonë për vete por edhe se e kishte kuptuar që ajo dhe partneri i saj duhet të punonin për t'i ndryshuar mendimet dhe veprimet e tyre. Ajo më vështroi drejt në sy me vëmendje, derisa qëndronim përballë njëra-tjetrës, duke u kapur për dore dhe më tha vazhdimisht: "Kam mjaft plagë brenda vetës". Ajo më falënderoi që takimi ynë, teorizimi ynë i racës, gjinisë dhe seksualitetit atë pasdite ia kishte lehtësuar dhimbjen, duke dëshmuar se mund të ndjente se lëndimi po largohej dhe se mund të ndjente një shërim që po ndodhte brenda. Duke më mbajtur duart, duke qëndruar trup më trup, sy më sy, ajo më lejoi të ndajë me empati ngrohtësinë e atij shërimi. Ajo donte që unë të dëshmoja, të dëgjoja përsëri si emërtimin e dhimbjes së saj, ashtu edhe fuqinë që u shfaq kur e ndjeu se dhimbja u largua.

Nuk është e lehtë të emërtojmë dhimbjen tonë, ta ndërtojmë teori nga ai vend. Patricia Williams në esenë e saj "Mbi të qenit objekt i pronës",¹² thotë se edhe ato/a të cila/ët janë "të vetëdijshme/ëm" ndjejnë dhimbjen që sjellin të gjitha format e dominimit (homofobia, shfrytëzimi klasor, racizmi, seksizmi, imperializmi). Duke ndarë nga përvoja e saj, Patricia Williams thotë:

Ka momente në jetën time kur ndihem sikur një pjesë e imja mungon. Ka ditë që ndihem aq e padukshme sa nuk më kujtohet çfarë dite të javës është, kur ndihem aq e manipuluar sa nuk mund të mbaj mend emrin tim, kur ndihem aq e humbur dhe e zemëruar sa nuk mund t'i them një fjalë të sjellshme njerëzve që më duan shumë. Këto janë kohët kur më bie në sy reflektimi im në vitrinat e dyqaneve dhe habitem teksa shoh një person që më shikon prapa... në raste të tilla më duhet të mbyllë sytë dhe të kujtoj veten time duke vizatuar një version të brendshëm që është i butë dhe i plotë."¹³

Nuk është e lehtë të emërtojmë dhimbjen tonë, të ndërtojmë teori nga ai vend. Unë jam mirënjohëse për shumë gra dhe burra që guxojnë të krijojnë teori nga vendndodhja e dhimbjes dhe vështirësisë, të cila/ët me guxim ekspozojnë plagët dhe tregojnë përvojën e tyre për të mësuar dhe udhëhequr, si një mjet për të skicuar shtigje të teorive të reja. Puna e tyre është çlirimtare. Ajo, jo vetëm që na mundëson ta kujtojmë dhe ta shërojmë veten por edhe na përmbush dhe na sfidon të ripërtërijmë angazhimin tonë ndaj një rezistence feministe aktive dhe gjithëpërfshirëse. Ne kemi ende shumë për të bërë kolektivisht drejt revolucionit feminist. Unë jam mirënjohëse që ne po kërkojmë kolektivisht si mendimtare/teoricente feministe për mënyrat se si ta bëjmë të mundur këtë lëvizje. Kërkimi ynë na kthen atje ku filloi gjithçka, në atë moment kur një grua ose

¹² Patricia Williams, Mbi të qenit objekt i pronës, në Alkimia e racës dhe e të drejtave: Ditari i një profesoreje të juridikut 216 (1991).

¹³ Id në faqe 228-229

një fëmijë, të cilat mund të ketë menduar se është krejtësisht vetëm, fillon kryengritjen feministe, fillon ta emërtojë praktikën e saj dhe të artikulojë teori nga përvoja e jetuar.

Le të imagjinojmë se kjo grua apo ky fëmijë po vuante nga dhimbja e seksizmit dhe shtypjes seksiste dhe donte të largonte dhembjen. Unë jam mirënjohëse që mund të jem dëshmitare e asaj që ne mund të krijojmë një teori feministe, një praktikë feministe, një lëvizje revolucionare feministe që mund t'i flasë drejtpërdrejt dhimbjes që është brenda njerëzve, duke ju ofruar atyre fjalë, strategji apo teori shëruese. Nuk ka njeri mes nesh që nuk e ka ndjerë dhimbjen e seksizmit dhe shtypjes seksiste, ankthin, mjerimin dhe pikëllimin e thellë dhe të paepur që mund të krijojë dominimi mashkullor në jetën e përditshme.

Mari Matsuda, na tregoi sot se ne "jemi duke u ushqyer me një gënjeshtër që në luftë nuk ka dhimbje."¹⁴ Ajo na tha se patriarkalizmi e bën të mundur këtë dhimbje. Catharine MacKinnon na rikujtoi se "ne i dimë gjërat me jetën tonë dhe e jetojmë atë njohuri, përtej asaj që ndonjë teori ka teorizuar".¹⁵ Ta krijojmë këtë teori është sfida përpara nesh. Sepse në prodhimin e saj qëndron shpresa e çlirimit tonë, qëndron mundësia e emërtimit të gjithë dhimbjes sonë - ajo e shërimit tonë. Nëse krijojmë teori e lëvizje feministe që adresojnë këtë dhimbje, nuk do ta kemi të vështirë të ndërtojmë një rezistencë feministe të bazuar në një masë që lufton. Kështu, nuk do të ketë hendek midis teorisë dhe praktikës feministe.

¹⁴ Mary Matsuda, fjalim i dhënë në një konferencë (9 shkurt 1991)

¹⁵ Catharine A. MacKinnon, Nga praktika në teori, ose sidoqoftë çfarë është një grua e bardhë?, 4 Yale J.L. & Feminizmi 13, 15 (1991)